



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 57 datë 30.09.2024

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 55 DATË 29.12.2023 “ PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR” I NDRYSHUAR.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe në mbështetje të nenit 54 gërma “dh” të ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit Nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, nenit 54 të ligjit Nr. 10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 475 datë 30.07.2021 “ Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 1 datë 24.01.2024”, VKB Nr. 29, datë 03.06.2021“Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontenier 1+1 dhe 2+1). VKB Nr.18 datë 20.02.2023 është miratuar lista shtesë për sitemimin edhe 2 të dy familjeve të reja të këtij komuniteti” i ndryshuar; VKB Nr. 55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër te ndryshuar si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të buxhetit miratuar me VKB. Nr. 55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar në vlerën **18,704,387 lekë** si më poshtë:

Pakësime viti 2024

Lekë

Nr	Nr Prog	Programi	Aktiviteti/ Emërtimi	Art.602 Shpenzime korente	Institucioni Likuidues
1	4520 Kap. 5	Rrjeti rrugor rural	P04520.Q1.O1.A3 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtesë) <i>A2 “Rikonstruksion Parkimi në Shirokë” (Blerje bazë materiale)</i>	18,704,387	Ndermar rja e Sherbimeve Puneve Publike
		Totali		18,704,387	

Shtesa viti 2024

Lekë

Nr.	Nr. Prog	Programi	Aktiviteti/ Emërtimi	Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndruesh të trupëz.	Institucioni Likuidues
1	10661 Kap. 5	”Strehimi Social”	P10661.Q2.O1.A3 Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale (qendra e romeve) <i>Zbatim</i>	6,969,000	Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

2	4220 Kap. 5	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatore ve	P04220.Q2.O1.A1.Trajtimi i qenve të rrugës. (shtese) i trasheguar A. 3 Ndërtimi i strehëzës së re për Qentë A. 3.1 Zbatim A. 3.2 Mbikqyrje A. 3.3 Kolaudim	11,343,000 355,591 36,796	Bashkia Shkoder
		Totali		18,704,387	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miraturar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kundër 10

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LU

